



This project is co-funded
by the European Union



KONVENTA PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA



ecim ritemi së bashku



KONVENTA PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Teksti është përpiluar në bazë të publikimit
“ Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”
Versioni original i këtij materiali, është publikuar
nga Shoqata për Vetëpërfaqësim.
Kjo shoqatë është shoqata e parë e personave me aftësi të
kufizuar intelektuale në Republikën e Kroacisë.
Shoqata “Ndihmoni Jetën” falenderon shoqatën, që e ka bërë të
mundur përdorimin e këtij materiali.

Për përgatitjen e broshurës janë përdorur vizatime dhe simbole **Widgit Symbols©**

Widgit Software 2002-2017

Web-faqja: www.widgit.com

Vizatimet dhe simbolet e përdorura në këtë broshurë janë
pronësi e Widgit Software dhe nuk mund të përdoren pa lejen e pronarit.

Përkthyer në gjuhën shqipe nga: Kosovo Mental Disability Rights Initiative, K-MDRI
dhe Përshtatur nga Shoqata “Ndihmoni Jetën”

Të gjitha shprehjet dhe emërtimet gramatikore mashkullore
të përdorura në këtë tekst përfshinë gjininë mashkullore dhe
femërore të personave që ju referohen.

Ky publikim u ribotua në kuadër të projektit “Të rinjtë me aftësi të kufizuar intelektuale,
advokojnë për përfshirjen e tyre sociale”, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe
zbatuar nga World Vision Shqipëri, SEEYN dhe Shoqata Ndihmoni Jetën.


Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.
Përmbajta e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyron
detyrimisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Hyrje

Këtë broshurë e kemi përgatitur me qëllim që t'ua lehtësojmë sa më shumë njerëzve njohjen me Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.



Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara duhet të sigurojë barazinë e kësaj kategorie njerëzish me të gjithë njerëzit e tjerë. Pra, personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë të drejta dhe liri të barabarta me ato që ka çdo qytetar.



Ju kujtojmë se në këtë broshurë do të flasim vetëm për Konventën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Është kjo arsyeja që gjatë prezantimit të broshurës, në vend të emërimit të plotë “Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, për lehtësi, apo shkurtim, do të përdorim vetëm emrin Konventa.




Rreth broshurës

Kjo broshurë na e paraqet Konventën me fjalë shumë të thjeshta e të kuptueshme.

Në broshurë nuk pasqyrohet e plotë çdo gjë që është shkruar në Konventë.

Nëse ju intereson çdo gjë që është e shënuar në Konventë, atëherë mund të drejtoheni në adresën apo telefonin e organizatës: Shoqata Ndhmoni Jetën. Të dhënat e kësaj organizate mund t'i gjeni në këtë material.



Cilat quajmë të drejtat e njeriut?

Të drejtat që dalin nga Konventa, i quajmë të drejtat e njeriut.

Të drejtat e njeriut janë të drejta që i takojnë kujtdo.

Të drejtat e njeriut na takojnë, sepse të gjithë jemi njerëz.




Të gjithë njerëzit janë të barabartë ndaj të drejtave të njeriut.

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejta të njëjta, sikurse personat pa aftësi të kufizuara.

Meshkujt dhe femrat janë të barabartë përpara të drejtave të njeriut.

Njerëzit e racave dhe besimeve fetare të ndryshme kanë të njëjtat të drejta të barabarta.



Të gjitha të drejtat e njeriut janë me rëndësi të barabartë për këdo.

Çdo njeri duhet të respektojë të drejtat e njeriut të të gjithë njerëzve të tjerë.

Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

Neni 1

Qëllimi

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejta të barabarta me të gjithë njerëzit e tjerë.

Personat me aftësi të kufizuara janë persona që kanë:

- Vështirësi mendore,
- Vështirësi në shikim,
- Vështirësi në lëvizje,
- Vështirësi në të dëgjuar,
- Vështirësi në kryerjen e disa aktiviteteve të tjera.

Disa lloje të aftësive të kufizuara nuk mund t'i vërehen shpejt.



Shtetet duhet të mundësojnë që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë të drejta dhe liri të barabarta me të gjithë njerëzit e tjerë.



Neni 2


Përkufizimet

Ja cili është kuptimi i plotë i disa fjalëve e shprehjeve të rëndësishme që përdoren në Konventë:

- Diskriminimi në bazë të paaftësisë, do të thotë që dikush sillet ndaj teje më keq se sa ndaj njerëzve të tjerë, sepse ti je person me aftësi të kufizuara.




- Përshtatja e arsyeshme, do të thotë që duhet të lihen mënjane pengesat që nuk lejojnë personat me aftësi të kufizuara të realizojnë barazinë me njerëzit e tjerë.
- Projektimi universal, do të thotë që të rregullohet çdo gjë në shoqëri në mënyrën më të thjeshtë, ku çdo njeri të ketë përaftrim në të.



Neni 3 Parimet e përgjithshme

Me rëndësi të veçantë është:

- Respektimi i dinjitetit dhe lirisë së zgjedhjes së personit me aftësi të kufizuara,
- Ndalimi i çfarëdolloj nënvlerësimi (përbuzjeje) ndaj personave me aftësi të kufizuara,
- Sigurimi i pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në shoqëri,
- Sigurimi që personat me aftësi të kufizuara të jenë të pranuar dhe të barabartë,
- Sigurimi i mundësive të barabarta në shoqëri për personat me aftësi të kufizuara,
- Sigurimi i barazisë së femrave me meshkujt,




- Respektimi i aftësive dhe të drejtave të fëmijëve me vështirësi.




Neni 4 Detyrimet e përgjithshme

Shtetet që njohin (pranojnë) Konventën duhet:

- Të nxjerrin ligje të reja që personat të realizojnë të drejtat e dala nga Konventa,
- Të anulojnë ligjet që nuk respektojnë të drejtat e dala nga Konventa,
- Të përkujdesen për respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara,
- Të përkujdesen që askush të mos diskriminojë personat me aftësi të kufizuara,
- Të përkujdesen që çdo gjë të jetë e thjeshtë dhe e kuptueshme për të gjithë njerëzit,
- Të sigurojnë specialistë që i ndihmojnë personat me aftësi të kufizuara të njihen me këtë Konventë,
- Të sigurojnë sa më parë të gjitha të drejtat që dalin nga Konventa.



Për të gjitha këto, qeverite duhet të merren vesh me shoqatat e personave me aftësi të kufizuara.



Neni 5

Barazia dhe mosnënvlerësimi

Shtetet që njohin Konventën, pranojnë se personat me aftësi të kufizuara janë të njëjtë dhe të barabartë me të gjithë njerëzit e tjerë.

Për këtë, të ndalojnë çdo nënvlerësim (përbuzje) të këtyre personave.



Shtetet duhet të kapërcejnë pengesat që ua bëjnë të pamundur personave me aftësi të kufizuara të realizojnë të drejtat e barabarta me njerëzit e tjerë.





Neni 6

Grate me aftësi të kufizuara

Shtetet duhet të pranojnë se grate me aftësi të kufizuara janë në pozitë më të vështirë se kushdo tjetër.

Për këtë, duhet të përkujdesen në mënyrë të veçantë për barazinë e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në shoqëri.



Neni 7

Fëmijët me vështirësi në zhvillim

Shtetet duhet të sigurojnë të drejta të barabarta për të gjithë fëmijët, pa dallime.

Shtetet duhet të përkujdesen veçanërisht për respektimin e të drejtave të fëmijëve me vështirësi në zhvillim.



Kur merren vendime për fëmijët me vështirësi në zhvillim, duhet pasur kujdes që këto vendime të jenë nga më të mirat për këta fëmijë.



Çdo fëmijë ka të drejtë të ndikojë në jetën e tij. Fëmijët me vështirësi në zhvillim kanë të drejtë të marrin ndihmë që të thonë lirisht gjithçka ata mendojnë.

Të rriturit duhet të vlerësojnë seriozisht atë që thonë fëmijët.

Neni 8


Ngritja e nivelit të vetëdijes

Shtetet nuk duhet të lejojnë që për personat me aftësi të kufizuara të flitet sikur janë persona të paaftë apo më pak të vlefshëm.

Personat me aftësi të kufizuara janë po aq të vlefshëm e të aftë sa dhe të tjerët.



Shtetet që pranojnë Konventën duhet të njohin qytetarët me të drejtat dhe aftësitë e personave me aftësi të kufizuara.



Për këtë duhet:

- Të zhvillohen fushata publike për të drejtat dhe aftësitë e personave me aftësi të kufizuara,
- Të mësohet nëpër shkolla detyrimi për respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara,
- Nëpër gazeta, në radio dhe televizion, të flitet më



shumë për aftësitë dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Neni 9

Qasja

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të bëjnë jetë të pavarur.

Shtetet duhet të kapërcejnë të gjitha pengesat që nuk lejojnë personat me aftësi të kufizuara:

- Të shkojnë në të njëjtat shkolla ku shkojnë të gjithë njerëzit e tjerë,
- Të punojnë në të njëjtat vende ku punojnë të gjithë njerëzit e tjerë,
- Të shkojnë në të njëjtat spitale ku shkojnë të gjithë njerëzit e tjerë,
- Të shkojnë në të njëjtat kinema dhe muze ku shkojnë të gjithë njerëzit e tjerë,
- Të shkojnë në të njëjtat kafene, restorante dhe klube ku shkojnë të gjithë njerëzit e tjerë,
- Të përdorin të njëjtat banka që përdorin të gjithë njerëzit e tjerë,
- Të përdorin të njëjtin autobusë dhe aeroplanë që përdorin të gjithë njerëzit e tjerë.



Shtetet duhet të sigurojnë që personat me aftësi të kufizuara të përdorin të gjitha ato mundësi e mjete që përdorin edhe njerëzit e tjerë në shoqëri.

Neni 10

E drejta për jetën

Të gjithë njerëzit kanë të drejtë të barabartë për jetën.

Askush nuk mund t'ia marrë jetën njeriut.




Neni 11

Situatat e rrezikshme dhe gjendja e jashtëzakonshme njerëzore

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të jenë të mbrojtur dhe të sigurt në rastet e:

- Luftës
- Fatkeqësive natyrore
- Situatave të tjera të rrezikshme



Neni 12

Barazia para ligjit

Personat me aftësi të kufizuara kanë aftësi të barabartë për punë si gjithë njerëzit e tjerë.

Kjo do të thotë se personat me aftësi të kufizuara mund të vendosin vet për veten e tyre, për çdo gjë të rëndësishme në jetë.




Personat me aftësi të kufizuara duhet të marrin sa më shumë vendime në mënyrë të pavarur. Ndonjëherë njerëzve u duhet dhënë ndihmë për disa vendime.

Shteti duhet të sigurojë përkrahje njerëzve. Përkrahja/Kujdestaria bën që personat të marrin vendimin më të mirë për veten e tyre.



Kujdestari duhet të dëgjojë dëshirat e personit. Kujdestari nuk duhet të marrë vendime në emër të personit.



Kujdestari nuk duhet të përzihet në vendimet që personi mund të marrë në mënyrë të pavarur. Puna e njerëzve që u ofrojnë përkrahje personave me aftësi të kufizuara duhet të kontrollohet. Gjykatat duhet të kenë kujdes, me qëllim që ata të cilët u ofrojnë përkrahje personave me aftësi të kufizuara ta kryejnë punën mirë dhe me ndershmëri.




Neni 13

Përafrimi në drejtësi

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të përdorin gjykatat në shtetin e tyre njëloj siç përdoren dhe nga qytetarët e tjerë. Shteti duhet të ndihmojë personat me aftësi të kufizuara që të realizojnë këtë të drejtë.



Njerëzit që punojnë nëpër gjykata, polici apo burgje, duhet të njihen me të drejtat dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara.



Neni 14

Liritë dhe siguria personale

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejta të barabarta për liri dhe siguri, si të gjithë njerëzit e tjerë.



Askush nuk mund të të burgosë vetëm e vetëm se je person me aftësi të kufizuara.

Personat me aftësi të kufizuara, që burgosen nga gjykata, kanë të drejta të barabarta si gjithë të burgosurit e tjerë.



Në burgje duhen kapërcyer pengesat që nuk lejojnë personat me aftësi të kufizuara të kenë të drejta të njëjta me të burgosurit e tjerë.



Neni 15

Liria nga tortura, trajtimi apo dënimi çnjerëzor

Personat me aftësi të kufizuara nuk duhet të torturohen, nëvlerësohen apo dënohen ashpër.



Personat me aftësi të kufizuara nuk duhet të detyrohen të marrin pjesë në eksperimente shkencore dhe mjekësore.



Neni 16

Liria nga shfrytëzimi, përdorimi i forcës dhe teprimi (shpërdorimi i detyrës)

Shtetet duhet të mbrojnë personat me aftësi të kufizuara nga shfrytëzimi, përdorimi i forcës dhe ushtrimi i presionit për shkak të detyrës.



Shtetet duhet t'u krijojnë mundësi personave me aftësi të kufizuara që të lajmërojnë kujdestaret për shfrytëzimin, forcën dhe teprimin në sjellje.



Shtetet duhet të kujdesen që personat me aftësi të kufizuara të jenë të mbrojtur nga përdorimi i forcës, (mbingarkesa) me detyrën dhe shfrytëzimi i njerëzve që u ofrojnë kujdestari .



Shtetet duhet të kujdesen që personat me aftësi të kufizuara, të cilët kanë përjetuar shfrytëzim, teprim në sjellje apo përdorim force, të riaftësohen dhe të përfshihen në shoqëri sa më parë.



Shtetet duhet të këmbëngulin që të zbulojnë dhe dënojnë çdo sjellje të tepruar, shfrytëzim apo përdorim force ndaj personave me aftësi të kufizuara.



Neni 17

Mbrojtja e paprekshmërisë së personit

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të jenë të respektuar në mënyrë të barabartë me të gjithë njerëzit e tjerë.



Neni 18

Liria e lëvizjes dhe shtetësia

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë:

- Të lëvizin lirisht në shtetin e tyre dhe jashtë shtetit të tyre,
- Të zgjedhin vendin ku dëshirojnë të jetojnë,
- Të kenë dokumentet e tyre personale dhe të udhëtimit,
- Të zgjedhin lirisht shtetësinë e tyre.



Fëmijët me vështirësi në zhvillim kanë të drejtë të marrin vesh se kush janë prindërit e tyre. Fëmijët me vështirësi në zhvillim kanë të drejtë të përfitojnë kujdestari dhe përkujdesje nga prindërit e tyre.




Neni 19

Jetesa e pavarur dhe përfshirja në shoqëri


Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të jetojnë në shoqëri si të gjithë njerëzit e tjerë.

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të jenë të pavarur në shoqëri si të gjithë njerëzit e tjerë. Shtetet duhet t'iu mundësojnë personave me aftësi të kufizuara jetesë dhe përfshirje në shoqëri.



Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të vendosin vet se ku do të jetojnë.

Askush nuk mund t'i detyrojë personat me aftësi të kufizuara të jetojnë të ndarë nga njerëzit e tjerë.



Shteti duhet t'u sigurojë përkrahje personave me aftësi të kufizuara.

Përkrahja duhet ta ndihmojë njeriun që të jetojë në shoqëri dhe të jetë i përfshirë në të.



Neni 20

Lëvizshmëria personale

Shtetet duhet të punojnë që personat me aftësi të kufizuara të fitojnë sa më shumë liri lëvizjeje.

Për këtë, shtetet duhet të mundësojnë personat me aftësi të kufizuara që:

- Të udhëtojnë me çmime më të arsyeshme,
- Të kenë përkrahje dhe pajisje për lëvizjen e tyre
- Të stërviten ata vet dhe personat që u japin përkrahje për shkathtësi gjatë lëvizshmërisë.



Neni 21

Liria e shprehjes së mendimit dhe marrjes së informacionit

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të shprehin lirisht mendimet, idetë dhe ndjenjat e tyre.



Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të shprehen në mënyrën më të përshtatshme për ta.



Shtetet duhet të mënjanojnë pengesat që ua bëjnë të pamundur njerëzve shprehjen e mendimeve, ideve dhe ndjenjave.

Shtetet duhet të përpiqen që gazetat, televizioni dhe interneti të jenë të thjeshta dhe të kuptueshme për personat me aftësi të kufizuara.



Neni 22

Respektimi i mendimeve e ndjenjave të fshehta

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejta të barabarta në fshehtësinë e mendimeve dhe ndjenjave të tyre, si gjithë njerëzit e tjerë.



Askush nuk duhet të na përgjojë.

Askush nuk duhet të hapë dhe të lexojë letrat tona.

Askush nuk duhet të na ofendojë.

Mjekët nuk duhet të japin të dhëna për mjekimin tonë.



Secili shtet duhet të mbrojë sekretet e personave me aftësi të kufizuara.

Neni 23

Respektimi i shtëpisë dhe familjes

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejta të barabarta vëllazërore, familjare dhe prindërore me të gjithë njerëzit.



Kanë të drejtë që lirshëm të lidhin kurorë dhe të krijojnë familje, si gjithë njerëzit e tjerë.

Kanë të drejtë të vendosin lirshëm se kur duan të kenë fëmijë.

Kanë të drejtë të vendosin vet se sa fëmijë duan të kenë.

Kanë të drejtë të mësojnë se çfarë është planifikimi familjar.

Kanë të drejtë të marrin ndihmën e nevojshme shëndetsore, në mënyrë që një ditë të mund të kenë fëmijë.



Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të jenë marrës, birësues apo kujdestarë të fëmijëve, si të gjithë njerëzit.

Kur vendoset për kujdestarin, marrësin apo birësuesin e fëmijës, duhet të kihet parasysh ajo që është më e mira për fëmijën.

Shteti duhet të ndihmojë personat me aftësi të kufizuara në përkujdesjen për fëmijët.



Fëmijët me vështirësi në zhvillim kanë të drejta të barabarta me të gjithë fëmijët e tjerë. Shtetet duhet t'iu sigurojnë përkrahje fëmijëve me vështirësi në zhvillim dhe familjeve të tyre.



Vetëm gjykata mund të vendosë që për fëmijën është më mirë të jetojë i ndarë nga prindërit e tij. Gjykata nuk duhet të vendosë që fëmija duhet të jetojë i ndarë nga prindërit, vetëm se janë prindër të personit me aftësi të kufizuara.



Shteti duhet t'i sigurojë secilit fëmijë rritje në rrethin familjar dhe shoqëror.

Nëse prindërit nuk mund të kujdesen për fëmijën e tyre, atëherë për të duhet të përkujdeset farefisi. Nëse për fëmijën nuk mund të kujdesen prindërit dhe farefisi, atëherë shteti duhet të gjejë një familjar që të përkujdeset për fëmijën.



Neni 24

Shkollimi

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejta të barabarta me të gjithë njerëzit e tjerë për shkollim.



Shtetet duhet të sigurojnë që:

- Të gjithë nxënësit nëpër shkolla të jenë të barabartë,
- Nxënësit me aftësi të kufizuara të zhvillojnë të gjitha aftësitë dhe talentet e tyre,



- Nxënësit me aftësi të kufizuara, pas përfundimit të shkollës, të përfshihen (të bëhen pjesë) në shoqëri me sukses.

Nxënësit me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të regjistrohen në shkolla të njëjta, si të gjithë nxënësit e tjerë.

Nxënësit nuk duhet të ndahen në shkolla speciale për shkak të aftësisë së kufizuar.

Shtetet duhet të përshtasin shkollat e rregullta që të jenë funksionale edhe për personat me aftësi të kufizuara.

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë për më shumë ndihmë në shkollat e rregullta.



Shtetet duhet t'i ndihmojnë personat me aftësi të kufizuara që pas shkollës të sigurohen në jetë, si të gjithë njerëzit e tjerë.

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të aftësohen e zgjerojnë njohuritë që ua lehtësojnë pjesëmarrjen në shoqëri.

Për shembull: shkrimin e Brajtit, gjuhën e shenjave, orientimin, shkathtësitë e lëvizshmërisë dhe shkathtësi të tjera.



Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të mësojnë dhe të arsimohen gjatë gjithë jetës.

Neni 25

Shëndeti

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejta të barabarta në mbrojtjen e shëndetit të tyre, si të gjithë njerëzit e tjerë.



Personave me aftësi të kufizuara shteti duhet t'u sigurojë:

- Sigurimin shëndetësor pa pagesë, sikurse e kanë edhe njerëz të shtresave të tjera,
- Shërbim shëndetësor të vazhdueshëm, që i ndihmon në ruajtjen e shëndetit të tyre,
- Shërbimet shëndetësore në komunitetin ku jetojnë,
- Detyrimin që mjekët të sillen ndaj tyre njëllor si ndaj gjithë njerëzve të tjerë,
- Të gëzojnë sigurim shëndetësor dhe jetësor të njëjtë me atë të njerëzve të tjerë.




Shteti duhet të ndalojë çdo përçmim (nënvlerësim) ndaj personave me aftësi të kufizuara në shëndetësi.

Neni 26

Aftësimi dhe rikthimi në një jetë të pavarur

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të aftësohen për një jetë të pavarur.

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të jenë të përfshirë në shoqëri.



Shtetet duhet të sigurojnë aftësimin e të gjithë personave me aftësi të kufizuara për një jetë të pavarur.

Aftësimi për jetë të pavarur duhet të fillojë qysh në fëmijëri.

Aftësimi për jetë të pavarur duhet t'i lehtësojë jetën personit në shoqëri dhe komunitet.



Shtetet duhet të sigurojnë ekspertë dhe programe cilësore në mënyrë që aftësimi për një jetë të pavarur të jetë i suksesshëm.

Shtetet duhet të sigurojnë zhvillimin e mjeteve që do të lehtësonin jetën e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.



Neni 27

Puna dhe punësimi

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejta të barabarta në punë me të gjithë njerëzit e tjerë.

Personat me aftësi të kufizuara nuk duhet të përçmohen (nënvlerësohen) as kur kërkojnë punë, as kur punësohen.



Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë që:

- të punojnë në vende të njëjta dhe së bashku me të gjithë njerëzit e tjerë,
- të fitojnë rrogë të njëjtë me të gjithë ata që punojnë në të njëjtën punë,



- të jenë anëtarë të sindikatave si të gjithë njerëzit e tjerë,
- të ndihmohen kur kërkojnë punë, si të gjithë njerëzit e tjerë,
- të marrin arsim cilësor, që të mund të punësohen,
- të përparojnë në punë, si të gjithë njerëzit e tjerë,
- të hapin kompaninë apo biznesin e tyre, sikurse gjithë njerëzit e tjerë,
- tu përshtatet vendi i punës në të cilën caktohen të punojnë.



Shteti duhet të nxisë punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Shteti ka të drejtë të japë mbështetje financiare, për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.



Shtetet duhet të sigurojnë mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara nga shfrytëzimi i egër dhe puna e mundimshme.

Neni 28

Nivel i njëjtë i jetesës dhe mbrojtja sociale

Shteti duhet të mbrojë personat me aftësi të kufizuara nga varfëria dhe uria, ashtu siç mbron edhe gjithë qytetarët e tjerë.



Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejta të barabarta në:

- kujdesin social,
- sigurimin e pensionit,
- zgjidhjen e problemeve të banimit.




Neni 29

Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë:

- të marrin pjesë në zgjedhje,
- të themelojnë apo të anëtarësohen në parti politike,
- të themelojnë apo të anëtarësohen në shoqata.




Pjesëmarrja në zgjedhje duhet të lehtësohet, në mënyrë që çdo person me aftësi të kufizuara të mund të marrë pjesë në zgjedhje.

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të votojnë sipas dëshirës.

Askush nuk ka të drejtë të të detyrojë të votosh për diçka që nuk ke dëshirë.

Askush nuk ka të drejtë të kërkojë ti bësh të ditur se si do të votosh.



Personat me aftësi të kufizuara që dëshirojnë të marrin pjesë në votime, kanë të drejtë të kërkojnë mbështetje për pjesëmarrje në zgjedhje.

Ata kanë të drejtë vet të zgjedhin personin që dëshirojnë t'i ndihmojë gjatë votimit.



Neni 30


Pjesëmarrja në jetën kulturore, zbavitje, argëtim dhe sport

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejta të barabarta në përdorimin e ambjenteve kulturore dhe sportive, si të gjithë njerëzit e tjerë.



Ambjentet kulturore janë:

- kinematë,
- teatrot,
- muzetë,
- bibliotekat,
- televizionet dhe gazetat.



Ambjentet sportive janë:

- terrenet sportive,
- pishinat,
- sallat sportive,
- sallat e ushtrimeve sportive
- stadiumet.



Neni 31

Statistikat dhe mbledhja e të dhënave

Shtetet duhet të mbledhin të dhënat për personat me aftësi të kufizuara.

Të dhënat e mbledhura duhet të sigurojnë zbatimin më të mirë të Konventës.



Me rastin e mbledhjes dhe shpërndarjes së të dhënave, duhet të ruhet privatësia e personave me aftësi të kufizuara.




Të dhënat për personat me aftësi të kufizuara mund të mblidhen dhe të shpërndahen vetëm ashtu siç është përcaktuar me ligj.


Neni 32

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Shtetet duhet të bashkëpunojnë ndërmejt tyre në zbatimin e Konventës.



Shtetet duhet të bashkëpunojnë me shoqatat e personave me aftësi të kufizuara në zbatimin e Konventës.




Çdo shtet që ka pranuar Konventën duhet të përpiqet të përmbushë gjithë atë që shkruhet në Konventë.

Neni 33

Zbatimi kombëtar dhe përcjellja

Shtetet të cilat pranojnë ose njohin Konventën duhet të themelojnë një njësi përfaqësuese.




Kjo njësi do të përkujdeset që Konventa të zbatohet me sukses në të gjitha aspektet e jetës.

Shtetet duhet të mbikëqyrin dhe promovojnë përdorimin e Konventës.



Në mbikëqyrjen dhe promovimin e Konventës duhet të marrin pjesë njerëz dhe ekspertë të pavarur.

Në mbikëqyrjen dhe promovimin e zbatimit të Konventës duhet të jenë të përfshira shoqatat e personave me aftësi të kufizuara.



Nenet

34, 35, 36, 37, 38 dhe 39

Nenet 34, 35, 36, 37, 38 dhe 39 bëjnë fjalë mbi Këshillin për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Shkurtimisht do të shpjegojmë se çfarë shkruhet në këto nene.



Kur njëzet shtete pranojnë Konventën, Kombet e Bashkuara duhet të themelojnë Këshillin për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Këshilli do të përkujdeset për zbatimin e Konventës. Shtetet që pranojnë Konventën duhet të bashkëpunojnë me Këshillin.




Kombet e Bashkuara duhet të sigurojnë hapësirën dhe mjetet për punën e Këshillit. Çdo dy vjet, Këshilli duhet të raportojë për punën e tij në Kombet e Bashkuara.



Shtetet që pranojnë Konventën duhet t'i raportojnë Këshillit për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Në raporte, shtetet duhet të shkruajnë çfarë kanë bërë për t'u siguruar njerëzve të gjitha të drejtat që burojnë nga kjo Konventë.

Në shkruarjen e raporteve shtetet duhet të marrin parasysh mendimin e personave me aftësi të kufizuara.




Në Këshillin për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara mund të jenë deri në tetëmbëdhjetë anëtarë.

Çdo shtet që pranon Konventën mund të propozojë anëtarë për në Këshill.

Shtetet duhet të kujdesen që, për anëtarë të Këshillit të propozojnë edhe persona me aftësi të kufizuara.

Anëtarët e Këshillit zgjidhen çdo katër vjet.


I njëjti person mund të zgjidhet deri në dy herë si anëtar i Këshillit.



Neni 40

Konferenca e shteteve anëtare

Shtete anëtare janë shtetet që kanë pranuar Konventën.



Çdo dy vjet mbahet konferenca e shteteve anëtare. Në të do të shqyrtohet zbatimi i Konventës.



Nenet 41 dhe 42

Nenet 41 dhe 42 flasin se kush e ruan tekstin origjinal të Konventës dhe si shtetet mund ta nënshkruajnë Konventën.



Versionin origjinal të Konventës e ruan Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Shtetet e nënshkruajnë Konventën në Selinë e Kombeve të Bashkuara.

Konventa ka filluar të nënshkruhet prej 30 Marsit të vitit 2007.



Nenet 43, 44 dhe 45

Nenet 43, 44 dhe 45 flasin se si shtetet pranojnë apo njohin Konventën dhe çfarë duhet bërë që Konventa të hyjë në fuqi.

Që të hyjë në fuqi Konventa, duhet:




1. Të paktën njëzet shtete ta nënshkruajnë Konventën në Kombet e Bashkuara
 2. Ta vërtetojnë Konventën parlamentet e atyre njëzet shteteve.
- Procedura e vërtetimit të Konventës në Këshill quhet ratifikim.



3. Kur parlamentet e njëzet shteteve njoftojnë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara se kanë ratifikuar Konventën.

Konventa mund të nënshkruhet në dy mënyra:

1. Shtetet e pavarura nënshkruajnë Konventën vet
2. Shtetet që janë të bashkuara me shtete të tjera, Konventën mund ta nënshkruajnë në mënyrë të pavarur apo të përbashkët. Për shembull: shtetet e Bashkimit Evropian, mund ta nënshkruajnë Konventën në mënyrë të pavarur, por mund të merren vesh që ta nënshkruajnë edhe në mënyrë të përbashkët.



Nenet 46, 47 dhe 48

Nenet 46, 47 dhe 48, flasin për zbatimin, ndryshimin dhe anulimin e Konventës.



Shtetet që pranojnë Konventën mund të vendosin nëse nuk do të zbatojnë disa nene nga Konventa.

Shtetet duhet të zbatojnë ato nene të Konventës që garantojnë barazinë e personave me aftësi të kufizuara.



Secili shtet mund të propozojë ndryshimin e Konventës.

Ndryshimet që propozon ndonjë shtet quhen amendamente (shtojcë, shtesa).

Për amendamentet (shtesat) e propozuara nga ndonjë shtet, diskutohet dhe votohet në Konferencën e shteteve anëtare.

Nëse në mbështetje të amendamentit (shtojcës) votojnë një numër i mjetueshëm i shteteve, ato bëhen pjesë përbërëse e Konventës.



Shteti që ka pranuar Konventën mund të vendosë vet nëse nuk dëshiron që ta zbatojë më atë. Ky quhet anulim i Konventës.

Për anulimin e Konventës, shteti duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.



Nenet 49 dhe 50

Nenet 49 dhe 50 flasin për mënyrën e prezantimit të Konventës për personat me aftësi të kufizuara si dhe gjuhëve në të cilat është shkruar varianti origjinal i Konventës.

Konventa duhet të jetë e kuptueshme për çdo njeri.

Për këtë, forma dhe përmbajtja e Konventës duhet të paraqitet në atë mënyrë që të jetë e kuptueshme për sa më shumë njerëz.

Broshura që tani ke në dorë është Konventa në formën më të thjeshtë.



Ajo është thjeshtëzuar në mënyrë të atillë që të jetë sa më e kuptueshme për personat me aftësi të kufizuara mendore.

Gjuhët në të cilat është shkruar varianti origjinal i Konventës janë:

- Arabisht,
- Kinezçe,
- Anglisht,
- Frëngjisht,
- Rusisht,
- Spanjisht.

Secili shtet që pranon Konventën, e përkthen atë në gjuhën e vet.

Përkthimi i Konventës, në secilin shtet, duhet të jetë i njëjtë me variantin origjinal të Konventës.

